



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 280/3 Prot.

Tiranë, më 10.02.2021

VENDIM

Nr. 19, datë 10.02.2021

PËR MIRATIMIN E KUOTAVE TË PRANIMIT
PËR VITIN AKADEMIK 2021-2022 NË UST

Në zbatim të nenit 68/3 të Ligjit Nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL-të e Republikës së Shqipërisë”, VKM nr.41, datë 24.01.2018, në Rregulloren dhe Statutin e UST-së, në kërkesat e Njësive Kryesore të UST për kuotat e pranimit në programet e ofruara prej tyre në vitin akademik 2021-2022, Senati Akademik i UST në mbledhjen e tij të datës 10.02.2021

VENDOSI:

1. Të miratojë kuotat e pranimit të studentëve në programet e studimit në Fakultetin e Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit, në Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes dhe Fakultetin e Shkencave të Rehabilitimit për vitin akademik 2021-2022 sipas tabelës bashkëngjitur këtij Vendimi.
2. Në vijim të ecurisë së regjistrimeve në programet e studimit, kapaciteti i kuotave të programeve përshtatet nga UST, në përputhje me interesat e studentëve, për programet e të njëjtit cikël studimesh e të së njëjtës njësi kryesore. Senati Akademik me propozim nga Rektorati, merr vendimin për rialokim të kuotave pa e tejkaluar kapacitetin e deklaruar të kuotave e të përcaktuar në nivel njësie kryesore, të miratuara në pikën 1 të këtij Vendimi.
3. Një kopje e këtij Vendimi dhe tabela e kuotave përcillet në MASR dhe QSHA.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi, ngarkohen Rektorati, Dekanët e Fakulteteve, Dega e Informacionit Studentor dhe Regjistrimeve.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof.Dr. AGRON KASA



